



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 4061

NR. VENDIMI 5165

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr.Regj.Them.4061

Nr. 5165 Vendimi

Dt.Regj.15.11.2018

Dt.15.07.2019

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, E PËRBËRË NGA:
ENEIDA CIVICI – GJYQTARE

Asistuar nga sekretare gjyqësore Anjeza Nergjoni, më datë 15.07.2019, përfundoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me Nr.4061 akti, që i përket:

PADITËS: Shoqëria ***, regjistruar si person juridik në datën ***, me seli në ***, përfaqësuar me Prokurë të Posaçme nr. ***, datë *** nga Av. ***, me nr. *** Licence, anëtar i Dhomës së Avokatëve ***, me adresë njoftimi për këtë gjykim: ***

I PADITUR: 1. Shoqëria ***, me seli në ***, përfaqësuar me Prokurë të Posaçme nr. ***, datë ***, nga Av. ***.

2. Shoqëria ***, me seli në ***, përfaqësuar me Prokurë të Posaçme nr. ***, datë ***, nga Av. ***.

OBJEKTI: -1. Detyrimi i të paditurve të ndalojnë menjëherë dhe përgjithmonë prodhimin, shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve bombol gazi nën logon "****", të ambalazuara në mënyrë të njëjtë/të ngjashme me marken e regjistruar "****", me ambalazhin dhe sfondet përkatëse dhe mos përsëritjen e këtyre veprimeve në të ardhmen për shkak se ky përdorim çënon të drejtat e pronësisë intelektuale të markës me reputacion të paditësit, si dhe përbën konkurrencë të pandershme, duke u urdhëruar të paditurit të tërheqin menjëherë nga tregu të gjitha produktet dhe materialet të cilat çënojnë ambalazhin e bombolës së gazit "****".

2. Detyrimi i të paditurve, të paguajnë shumën prej *** Euro, si dëm jopasuror i shkaktuar paditësit.

3. Publikimin e vendimit të Gjykatës në dy media publike të shkruara, në faqe të parë, për 5 ditë rresht, me shpenzimet e të paditurve.

4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

BAZA LIGJORE: Nenet 156/2/b/c, 184/a, 184/b, 184/c të Ligjit nr.9947 datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, nenet 638, 639 të K.Civil, nenet 31, 32/a, 154 e vijues, 348 të K.Pr.Civile.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, degjoi pretendimet perfundimtare te perfaqesuesit te pales paditese, i cili kerkoi: Pranimin e kerkese padise sipas objektit te saj, perfaqesuesin e pales se paditur qe kerkoi: Rrezimin e kerkese-padise si te pa bazuar ne prova dhe ne ligj, pasi e shqyrtoi çështjen ne teresi, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor,

VEREN :

Cështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka kompetencën për gjykimin e saj në bazë të Nenin 41 të K. Pr. Civile : "Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera". Meqënëse ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje me karakter tregëtar që rrjedh nga marrëdhënia juridiko – tregtare e pronësise mbi markat, gjykata referuar dhe Neneve 334-335 të K. Pr. Civile çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencën tokësore në bazë të Nenit 43 të K. Pr. Civile, "Kur i padituri është person juridik paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka qendren e tij...". Nga ana tjetër neni 348 i K. Pr. Civile percakton se :«Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjt tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod".

Sa me sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane ka kompetencën për shqyrtimin e kesaj çështjeje objekt konflikti.

Rrethanat e faktit :

Paditesi, shoqëria tregtare *** është regjistruar si person juridik në datën ***, me NUIS: ***, me objekt aktiviteti tregëtar ndër të tjera dhe tregëtinë e import eksportin e mallrave ushqimorë e industriale, të tilla si bombolat e gazit etj.

Pala e paditur shoqëria *** me NUIS: *** është regjistruar si person juridik në dt. *** dhe si objekt të veprimtarisë së tij ka: "Import eksport, depozitimin, transportimin e tregtimin me shumice e pakice të gazit të lengshëm, mbushja e tregtimit me shumice të bombolave të gazit të të gjitha llojeve. Tregtim me shumice e pakice të karburanteve, lubrifikanteve, të naftës bruto, gazit dhe nenprodukteve të tyre, të alkoolit për frenat, goma e pjesëve të ndryshme të këmbimit për automjete, tregtim me pakice të gazit të lengshëm për automjete dhe shërbime të tjera për automjete. Ngritja e pikave për ruajtjen dhe tregtimin me shumice të këtyre produkteve si dhe tregtimin e të gjitha pajisjeve të nevojshme për konsumimin e tyre.

Pala e paditur shoqëria *** me NUIS: *** është regjistruar si person juridik në dt. *** dhe si objekt të veprimtarisë së tij ka: Tregtim me shumice e pakice dhe import-eksport të mallrave industriale, ushqimore, fruta-perime, veshmbathje e konfeksione, lende të para, pjesë këmbimi për makineri, pije të ndryshme, hidro-sanitare, hidraulike, kancelari për zyra e shkolla, orëndi shtëpiake, mobilje, pajisje elektrike, e elektronike, kompjuterike, këmbalieri, elektro-shtëpiake, pjesë këmbimi për automjete, produkte bujqësore e blegtorale, produkte të detit, bime medicinale etero vajore e mjekësore, prodhime kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimike dhe detergjente, materiale të ndryshme ndertimi. Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit. Prodhim e tregtim me shumice e pakice të të gjitha llojeve të materialeve të ndertimit import-eksport. Agjensi imobiliare. Në fushën e shërbimeve të ndryshme si perpunim e prodhim të materialeve të drurit, të hekurit, duraluminit, plastike. Hapje pike servise, lavazhe.

Rezulton se pala paditese ka në pronësi të saj markën tregtare të regjistruar "*****" nr. *** datë *** sipas njoftimit për lëshim ekstrakti nr. *** datë *** të DPPI me emërtim markë *** (e kuqe, jeshile, bojë qielli, fjalë dhe vizatim) klasat 6 (bombul gazi), 29, 30, 32 me afat mbrojtje deri në datë 04.02.2010. Marka është regjistruar gjithashtu për bombul gazi *** (jeshile e bardhë) (tre dimensionale) me nr. *** në datë *** me datë depozitimi kërkesë ***. Gjithashtu marka është regjistruar me numër regjistrimi *** dhe me datë regjistrimi *** dhe datë të mbarimit të mbrojtjes *** , me ngjyra që mbrohen e kuqe, jeshile, blu për

klasat 6 (bombul gazi),29,30, 32. (fjale e vendosur brenda një rombi, vizatim)
Palët e paditura në datë *** kanë lidhur me shoqërinë *** një akt marrëveshje sipas së cilës ata kanë rënë dakort për përdorimin, prodhimin, tregëtimin dhe shpërnbarjen e produkteve të ndryshme nën logon dhe emërtimin e markave në pronësi të shoqërisë ***.

Rezulton se shoqëria *** ka patur të regjistruar markën *** (jeshile e bardhë) (tre dimensionale) me nr. *** rregjistrimi datë *** me datë depozitimi kërkesë *** rregjistrimi dhe datë mbarimi të mbrojtjes ***.

Parashikimet ligjore:

Ligji nr. 9947 datë 07.07.2008 i ndryshuar parashikon se:

Neni 156

Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi

1. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës, në përputhje me të drejtat e parashikuara në këtë ligj.
2. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij:
 - a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka;
 - b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare;
 - c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës.
3. Në përputhje me pikën 2 të këtij neni, gjithashtu, ndalohet:
 - a) vendosja e shenjës te mallrat ose ambalazhet e tyre;
 - b) hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, duke përdorur këtë shenjë, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave për këto qëllime;
 - c) ofrimi i shërbimeve, duke përdorur këtë shenjë;
 - ç) importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur këtë shenjë;
 - d) përdorimi i shenjës në veprimtarinë tregtare, në reklamime ose publicitete.

Neni 184/a

E drejta për të vepruar kundër shkeljes së të drejtave

1. E drejta për të ngritur padi në gjykatë për shkelje të të drejtave, sipas këtij ligji, i përket:
 - a) pronarit të një patente, disenjoje ose marke të regjistruar;
 - b) përdoruesit të autorizuar të një marke kolektive ose treguesi gjeografik;
 - c) mbajtësit të një licence ekskluzive për një patentë ose aplikimi për patentë, në përputhje me kreun XXX, si dhe mbajtësit të një licence për një disenjo industriale ose marke, në përputhje me nenet 129 dhe 163, të këtij ligji;
 - ç) pronarit të një marke të mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, në përputhje me shkronjën “ç”, të pikës 5, të nenit 143, të këtij ligji.
2. Pronari i një patente ose i një aplikimi për patentë ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë kundër çdo personi, që ka shkelur, po shkel ose rrezikon të shkelë të drejtat mbi patentën. Megjithatë, gjykata mund të mos vendosë në themel për çështjen, derisa të publikohet patentat e dhënë.

Neni 184/b

Procedurat në rast shkeljeje

1. Personat e përmendur në nenin 184/a, të këtij ligji, kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kundër çdo personi, që shkel të drejtat e tyre për të kërkuar:
 - a) ndalimin e mallrave/shërbimeve që shkelin të drejtat e personave që parashikohen në nenin 184/a;
 - b) heqjen ose bllokimin nga qarkullimi civil i materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura kryesisht për krijimin ose prodhimin e mallrave ose shërbimeve që shkelin të drejtat;
 - c) në lidhje me mallrat e paligjshme (counterfeiting), thjesht heqja ose shkëputja e markës së ngjitur në këto mallra nuk është e mjaftueshme, përveçse në raste përjashtimore për të lejuar hedhjen në treg të këtyre mallrave.
 - ç) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në mediane publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata.
2. Gjykata urdhëron zbatimin e masave të parashikuara në pikën 1, shkronjat "b" dhe "c", të këtij neni, me shpenzimet e shkelësit, përveç kur ka arsye të veçanta për të vendosur ndryshe. Në shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masave të parashikuara në pikën 1, shkronjat "b" dhe "c", gjykata vlerëson proporcionalitetin midis rëndësisë së shkeljes dhe masës së urdhëruar, si dhe interesat e palëve të treta.
3. Masa e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, mund të merret edhe ndaj një ndërmjetësi, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur një të drejtë të pronësisë industriale.
4. Padia kundër shkeljes së të drejtave duhet të depozitohet në gjykatë, brenda tre vjetëve nga data kur paditësi merr dijeni për shkeljen dhe shkelësin.

Neni 184/c

Shpërblimi i dëmeve

- Shkelësi është përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar paditësit. Gjykata, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, vendos për masën e dëmshpërblimit, përveç kur është parashikuar ndryshe. Gjykata, në caktimin e masës së dëmshpërblimit:
- a) mban parasysh çdo dëm efektiv dhe real, përfshirë edhe fitimin e munguar, që ka pësuar pala e dëmtuar, çdo fitim të padrejtë, të realizuar nga shkelësi, si rezultat i konkurrencës së pandershme dhe, sipas rastit, edhe dëmin moral shkaktuar mbajtësit të të drejtave nga shkelja, cenimin e emrit apo të reputacionit të tij tregtar etj.;
 - b) sipas rastit, mund të vendosë shpërblimin e menjëhershëm të dëmit duke llogaritur fitimet që do të siguroheshin ose do të merreshin në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizim për përdorimin e së drejtës së pronësisë industriale në fjalë.

Në Kodin Civil parashikohet se:

Neni 638

Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shënjjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që:

1. përdor emrat ose shënjjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti;
2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit;
3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.

Neni 639

Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat.

Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin.

Në përfundim të analizën e faktit dhe të ligjit, gjykata do të mbajë në konsideratë nenin 16 të Kodit të Proçedurës Civile, I cili parashikon se gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të bëjnë palët.

Në vendimin unifikues Nr.9 datë 09.03.2006 Gjkata e Lartë ka unifikuar praktikën se gjykata është e detyruar që të bëjë cilësimin e saktë të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike, por pa ndryshuar bazën ligjore të padisë e cila është vetëm në disponim të paditësit.

Në vendimin nr.3 datë 29.03.2012 Gjkata e Lartë ka unifikuar praktikën se: Në këtë kuptim, gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojtë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cënuar.”

A është marka tregtare “****” marke e mirenjohur ne Shqiperi ?

A jemi perpara konkurences se pandershme per shkak te produkteve te tregtuara nga palet ndergjyqese ?

Sa i përket çështjes së parë të shtruar për zgjidhje në arsyetimin e këtij vendimi, gjykata vlerëson se kushti ligjor i mbrojtjes së markes tregtare, krahas kritereve të tjera ligjore është dhe mirenjohja e saj në vendin ku perdoret si e tille.

“Markat e mirënjohura” mbrohen nëpërmjet zbatimit të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (1883) e ndryshuar, (Konventa e Parisit) dhe Neni 16 i Marrëveshjes mbi Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIPs). Qëllimi i Nenit 6bis të Konventës së Parisit është të mbrojtë markat tregtare të mirënjohura. Vendet e saj anëtare i nënshtrohen detyrimit të refuzojnë ose anulojnë regjistrimin e markave tregtare të cilat janë konfuzo apo të ngjashme me një markë të mirënjohur, apo/dhe të ndalojnë përdorimin e tyre. Parakusht për mbrojtjen e një marke të mirënjohur është ngjashmëria e produktit. Megjithatë, mbrojtja shtrihet përtej ngjashmërisë së produktit, kur përdorimi i markës tregtare do të shfaqte një lidhje midis produkteve dhe pronarit të markës tregtare të mirënjohur, e cila ndoshta do ti shkaktonte dëm pronarit të markës tregtare.

Kriteret ligjore të percaktuara me sipër para në raport me Konventën që ti japin një marke statusin “marke e mirenjohur” kërkojnë nga gjykata që vlerësimin e tyre ta bëjë në përputhje me kuptimin dhe qëllimin që kanë në vetvete këto terma të përdorura në ligj para në raport me rrethanat konkrete. Kështu koncepti “përdorim” nënkupton për gjykatën se pari përdorimin e saj minimalisht në një grup të caktuar të interesuarish dhe maksimalisht për publikun e gjere dhe se dyti kohezgjatja e këtij përdorimi përben kriter tjetër vlerësues për gjykatën për dënimin e këtij statusi. Koncepti i “reklamimit ose publikimi” lidhet me evidentimin e kesaj marke nepermjet formave te ndryshme te te berit publike si reklama,

spote publicitare, postera, flete-palosje etj.

Gjykata çmon se u provua gjyqesisht se kjo marke tregtare eshte e mirenjohur ne tregun shqiptar per sa kohe qe ajo si e tille eshte tregtuar qe nga viti 2003 e me vone nga shoqeria tregëtare me të njëjtin emër ***. Nga pala paditese, u provua edhe fakti i qenies se kesaj marke dhe produktit qe ajo tregton si mall konsumi i perditshem nga popullata (konsumatori) duke provuar dhe reklamimin e saj në televizione kombëtare. Pala paditëse provoi në gjykim se ajo importon sasi të konsiderueshme të këtij produkti referuar shkresës nr. *** datë *** të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Ne lidhje me pretendimin e konkurrences se pandershme, gjykata vëren se Kodi Civil ka përcaktuar elementet për të garantuar mbrojtjen ligjore të shenjave dalluese dhe të drejtave të patentës, dhe në nenin 638 parashikon se, “veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që: (i) përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; (ii) trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit; (iii) përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit”.

Për më tepër, neni 639 parashikon se: “Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat. Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin”.

Ne gjykim u provua, se pala paditëse importon bombul gazi, me ngjyrë jeshile, me emrin « *** » të shkruar më ngjyrë të kuqe, brenda një rombi të vijëzuar me të bardhe, me germa jo me të njëjtin dimesion të vendosur ne pjesën e sipërme të bombulës së gazit. Ndërkohë palët e paditura tregëtojnë një produkt të dizenuar bombul gazi me ngjyrë jeshile, me emrin « *** » të shkruar më ngjyrë të kuqe, brenda një rombi të vijëzuar me të bardhë, me germa jo me të njëjtin dimesion të vendosur ne pjesën e sipërme të bombulës së gazit. Si në emërtimin « *** » ashtu dhe në emërtimin « *** » me të njëjtat karakteristika të shkrimit si në pjesën e sipërme gërma e parë « E » dhe e fundit « A » janë më të vogla ndërkohë që gërmat e mesit janë më të mëdha. Disenjoja e gërmave « E » dhe « A » është identike duke ndryshuar në këto emërtime vetëm gërma K nga R. Edhe në pjesët anësore të bombulave të gazit vendosja e emërtimeve « *** » dhe « *** » është në të njëjtën lartësi, me ngjyrë të kuqe, brenda një rombi të vijëzuar me të bardhë. Disenjoja e gërmave « E » dhe « A » është identike duke ndryshuar në këto emërtime vetëm gërma K nga R.

Gjykata çmon se përse kohë ngjyrat jeshile të bombulave të gazit janë identike, shkrimet « *** » dhe « *** » janë të shkruar më ngjyrë të kuqe të njëjtë për nga fortësia e ngjyrës, ndodhen të shkruara brenda një rombi të vijëzuar me të bardhe, me germa jo me të njëjtin dimesion ku gërma e parë « E » dhe e fundit « A » janë më të vogla ndërkohë që gërmat e mesit janë më të mëdha, disenjoja e gërmave « E » dhe « A » është identike duke ndryshuar në këto emërtime vetëm gërma K nga R, janë vendosur në të njëjtin pozicion të ambalazhit si në pjesën e sipërme ashtu dhe në pjesën anësore, rezulton se krijojnë nje konfuzion ne treg, si bashkelidhje midis markave, si dhe ne marrjen e perfitimeve nga reputacioni i markave te paditesit. Gjykata çmon se përse kohë emri i shoqërisë pra emri tregëtar i paditësit, që tregëton bombulat e gazit « *** » është i njëjtë me emrin e shënuar në këto produkte por dhe në produkte të tjera të tregëtuara nga paditësi, atëherë konfuzioni qe krijohet te konsumatori është i dukshëm që krijon bindjen se të dyja këto ambalazhime janë produkte të tregëtuara nga paditësi. Gjykata çmon se dhe nga pikëpamja fonetike dhe jo vetëm vizuale këto dy emërtime figurojnë realisht shumë të ngjashme përse kohë shqiptimi i tyre ndryshon vetëm në

një gërmë.

Gjykata vëren se paditësi arriti të provojë se ai kryen shpenzime të konsiderueshme me qëllim reklamimin e mallit por dhe të emrit të vetë tregëtar ndërkohë që palët e paditura nuk paraqitën asnjë provë të tillë dhe për rrjedhojë është e dukshme se i gjithë përfitimi krijohet në mënyrë të padrejtë nga të paditurit si pasojë e mirënjohjes së markës së paditësit për shkak dhe të investimit që ai kryen në këtë drejtim.

U provua në gjykim sipas shpjegimeve të pales paditese dhe provave të administruara, ekzistenca e ngjashmerive në ambalazhime të produkteve të markuara. Gjykata e cmon se ambalazhet e produkteve, krijojnë konfuzion tek konsumatori mesatar duke marrë në konsideratë që produktet e të dy markave përdorin të njëjtat kanale shpërndarjeje dhe tregtohen në të njëjtat dyqane dhe supermarkete, madje shiten edhe në të njëjtat raftë, njëra pranë tjetrës. Po kaq i rëndësishëm është fakti që marketingu dhe reklamimi i këtyre produkteve ju drejtohet të njëjtit grupmoshe konsumatorësh.

Rreziku i konfuzionit/ nga konsumatori mesatar intensifikohet edhe për arsye të faktit që paditësi këtë emër e ka dhe emrin e vet tregëtar nën të cilin reklamon dhe tregëton dhe produkte të tjera duke gëzuar statusin e markës së mirënjohur. Sa më e lartë është shkalla e konsolidimit dhe njohjes së një marke, sigle, logoje apo tipari dallues, aq më e lartë është fuqia dalluese që ka dhe aq më të rrepta janë kushtet për përjashtimin e rrezikut për konfuzion. Me fjalë të tjera, kërcenimi i rrezikut për konfuzion është më i madh tek shenjat dhe tiparet dalluese që kanë fituar fuqi të madhe dalluese, janë bërë të mirënjohura dhe kanë autoritet në treg. Rrjedhimisht, tiparet dalluese dhe shenjat e mirënjohura apo me reputacion të madh gëzojnë mbrojtje të shtuar ligjore në raport me shenjat dhe tiparet dalluese të zakonshme, sepse në to diferencimi i mjaftueshëm kërkon ndryshim të madh të karakteristikave të krahasuara të dy palëve.

Duke përdorur një ambalazh tregtar të ngjashëm me ambalazhin tregtar me reputacion të lartë në tregun Shqiptar, i padituri jo vetëm që përfiton në mënyrë të jashtëligjshme nga atraktiviteti dhe prestigji i markës së mirënjohur, por madje edhe shfrytëzon arritjet publicitare duke shmangur shpenzimet dhe efortin e tyre për marketing. Mjafton fakti që i padituri ka zgjedhur të largohet nga imazhi i mallrave të tij tregtare dhe të përdorë aktualisht një ambalazh tregtar shumë të ngjashëm me atë të produkteve të paditësit, për të vërtetuar qëllimin e të paditurit të realizojë një përfitim të padrejtë nga marka e mirënjohur të cilën paditësi e ka dhe emër tregëtar. Përveç përfitimit të padrejtë, i padituri, duke qenë një konkurrent i drejtëpërdrejtë i paditësit, po dëmton rëndë aktivitetin e biznesit të paditësit. Fakti që nga i padituri, është zgjedhur kombimi i atillë i ngjyrave dhe i konceptit vizuar për ambalazhin/paketimin e produkteve, të çon në përfundimin se qëllimi i këtij veprimi është përfitimi i avantazheve të padrejta nga marka e mirënjohur e paditësit.

Pala e paditur paraqiti një Deklaratë Noteriale e bërë nga një shtetas grek ***, në datën *** në Athinë, Greqi. Sipas kësaj deklarate ky pretendon se duke qenë i përfshirë në artet grafike që nga viti 1980, në muajin Maj 1997 është vizituar nga shtetasi shqiptar ***, si përfaqësues i shoqërisë ***. dhe ky i fundit i ka kërkuar të krijojë disa makete në mënyrë që t'i përdorte ato në bombula gazi LPG, në madhësi të ndryshme që kompania e tij do të dispononte në treg. Po sipas deklaruesit, një element bazë i maketave ishte se ato mbanin në mënyrë alternative, tipare dalluese “**** ****” ose “**** ****”, shkruar në mënyra të ndryshme.

Pala paditëse e kundërshtoi këtë deklaratë duke pretenduar se: Përveç faktit që përkthimi në gjuhën shqipe është i metë, sipas deklaruesit shtetas grek, ai ka përgatitur maketet bashkëlidhur deklaratës, por nga shqyrtimi i tyre, dukshëm provohet pavërtetësia e deklarimeve të tij dhe fakti se këto makete (duke u përqendruar në veçanti tek 2 të parat, me tiparet dalluese “**** ****” ose “**** ****”) nuk mund të jenë prodhuar prej tij në vitin 1997.

E theksojmë këtë moment, pasi pavërtetësia e deklaramit të njëanshëm të shtetasit grek, rezulton e qartë nga fakti që maketi i pretenduar se është “krijuar” prej tij në vitin 1997, mban shënimin se ai është në përputhje me “****”. Por ***, përfaqëson standardin Evropian për bombolat metalike të gazit nën presion, miratuar në datën 05.03.2009 dhe e cila ka vijuar të jetë në fuqi deri në momentin e miratimit të standardit EN 417:2012, në datën 12.04.2012. Pra, në vitin 1997, provohet plotësisht se nuk mund të krijohet një maket i tillë, i cili do të përmbante standarde dhe shënime të cilat janë krijuar plot 12 vite më vonë! Ky fakt provon, me provat e vetë palës së paditur, se deklaramet e shtetasit grek janë jo të vërteta dhe duhet të vlerësohen nga gjykata në drejtim të pranueshmërisë së argumenteve tona në këtë padi. Po ashtu, logo “****”, përfaqëson kodin përkatës të Listës së Mallrave të Rrezikshme të miratuar nga OKB, në vitin 2013, për bombulat e gazit jo të rimbushme, nën presion. Pra, edhe ky Kod është miratuar shumë vite më vonë, nga viti 1997, i pretenduar në mënyrë të pavërtetë nga deklaruesi. Për më tepër, në maketin e pretenduar janë shënuar edhe dy nr. telefoni celular, konkretisht: *** dhe ***, të cilët i përkasin shoqërisë telefonike celulare “****” e cila jo vetëm që këto nr i ka futur në qarkullim shumë më vonë (pas vitit 2010), por edhe vetë subjekti tregtar “****”. provohet se është krijuar si shoqëri tregtare dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar vetëm duke filluar nga data 15.05.2001!! Pra, në vitin 1997 as nuk ekzistonte kjo shoqëri në Shqipëri dhe sigurisht as këto nr telefoni nuk mund të vendoseshin në maketën e pretenduar se ka konceptuar deklaruesi, shtetasi grek. Dhe në përfundim, elementi po kaq i rëndësishëm që hedh poshtë katërcipërisht pretendimin e krijimit të këtij maketi në vitin 1997, është fakti se në atë maket, shënohet se bombula është prodhuar nga ***, i padituri në këtë gjykim, në një kohë kur provohet se ky subjekt juridik është themeluar vetëm në datën 09.02.2012!! Pra, kjo shoqëri tregtare NUK ekzistonte 15 vite përpara asaj date, në vitin 1997!

Gjykata vëren se pala e paditur në gjykim nuk arriti të shpjegojë dhe as të kundërshtojë asnjë nga pretendimet e paditësit lidhur me këtë deklaratë as gjatë gjykimit kur u ngritën si pretendime dhe as në diskutim përfundimtar.

Gjykata në fakt i gjen të drejta dhe të bazuara pretendimet duke krijuar bindjen se të paditurit kanë shkelur dispozitat e Kodit Civil në lidhje me konkurrencën e pandershme duke kopjuar elementët e paraqitjes grafike të ambalazheve të produktit bombul gazi të tregëtuar nga paditësi.

Lidhur me kerkimin e objektit te kerkese-padise persa i perket demit te shkaktuar per efekt te konkuresces se pandershme, gjykata çmon se konflikti gjyqesor buron nga marrëdhënia juridike e demshperblimit jashte kontraktor e cila gjen rregullim ne Nenin 608 e vijues te K.

Civil si dhe ne rregullimet e posaçme te legjislacionit mbi demet jashtekontraktore te shkaktuara te treteve nga mjetet motorike. Ky nen jep përkufizimin e shkaktimit të demit. Sipas kësaj dispozite: “Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkaktonte tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.”

Neni 609 i K. Pr. Civile percakton se: “Demi duhet te jete rrjedhim i drejtperdrejt dhe i menjehershem i veprimit ose mosveprimit te personit”. Nga interpretimi i dispozites së mësipërme rezulton se katër janë kushtet që të lindi detyrimi nga shkaktimi i demit jashtë kontraktor. Konkretisht: a) të ekzistojë dëmi; b) ekzistenca e paligjshëmërisë së veprimit ose mosveprimit; c) ekzistenca e fajit; d) lidhja shkaksore midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojës (dëmit) të ardhur. Të katër këto kushte duhet të qëndrojnë bashkarisht (në mënyrë kumulative) që të ekzistojë detyrimi.

Veprimi i paligjshem ne shkaktimin e demit cilesohet nje kategori objektive, shfaqja e kundraligjshme e vullnetit te subjektit te se drejtes qe sjell si pasoje shkeljen ose cenimin e te

drejtave, lirive dhe interesave te te treteve qe mbrohen nga rendi juridik dhe zakonet e mira. Kundraligjshmeria e sjelljes se subjektit shkaktar te demit cenon marrredheniet juridike, qe gezojne mbrojtje nga Kushtetuta, aktet nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore, te cilat njohin dhe garantojne te drejtat e personave fizik dhe juridik ne raport me njeri-jetrin dhe pushtetin publik.

Faji eshte qendrimi subjektiv i personit shkaktar te demit ne raport me veprimin e kundraligjshem dhe pasojat qe vijne prej tij, qe nenkupton vullnetin e brendshem psikik per te kryer veprimin, per te siguruar ardhjen e pasojave ose lejjimin e ardhjes se tyre. Lidhja shkakesore vleresohet si ekzistenca e lidhjes objektive, te drejtperdrejte dhe te pavarur nga vullneti i subjektit shkaktar te demit mes veprimit te kundraligjshem dhe pasojes se ardhur. Lidhja shkaksore verteton lidhjen mes tre elementeve objektive dhe subjektive te faktit te paligjshem; konkretisht sjelljes se paligjshme, fajit dhe pasojes se ardhur, pra demit te shkaktuar ne pasurine, shendetin ose personalitetin e subjektit te demtuar. Elementi i lidhjes shkakesore mbeshtetet ne parimin condicio sine qua non sipas te cilit nuk do te vertetohej ardhja e pasojes se demshme nese nuk do te kishte ndodhur shkaku, sjellja e paligjshme dhe faji per shkaktimin e demit.

Demi i cili mund te kete karakter pasuror ose jo-pasuror.

Neni 640 i Kodit Civil parashikon se: "Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore."

Ne gjykimet me objekt detyrimet qe rrjedhin nga shkaktimi i demit, nese paditesi kerkon demshperblimin "per te gjitha demet" apo "per te gjitha demet pasurore e jopasurore", kjo menyre kerkimi perben disponimin e tij per kerkimin e demshperblimit per cdo figure te demit pasuror e jopasuror. Por, nese kerkese-padia permban kerkime per demshperblimin e figurave konkrete te demit jashtekontraktor, gjykata ka detyrimin t'i permbahet ne gjykim dhe vendim ketyre kerkimeve specifike.

Ne rastin e shkaktimit të demtimit per shkak te konkurences se pandershme, sikurse ka ndodhur ne çeshtjen objekt i ketij gjykimi, paditësi që ka pësuar këtë dëm ka legjitimim aktiv per kerkimin e demshperblimit te demit pasuror te pesuar.

Neni 608 i K.Civil parashikon demshperblimin per demet jashtekontraktore te pesuara nga vete i demtuari "ne personin ose ne pasurine e tij" dhe jo ato te pesuara ne shendetin a pasurine e te treteve.

Sipas Neni 608 te K.Civil: "Personi qe ne menyre te paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit nje dem ne personin dhe pasurine e tij, detyrohet te shperbleje demin e shkaktuar". Kjo dispozite parashikon faktin juridik njerezor te sjelljes se paligjshme dhe me faj te nje personi qe i shkakton dem nje personi tjetër fizik apo juridik. Nese vertetohet fakti i paligjshem dhe lidhja shkakesore e tij me demin, lind marrredhenia e detyrimit, e drejta subjektive e personit te demtuar per te kerkuar demshperblim dhe detyrimi i personit pergjegjes per t'a shlyer ate.

Ne interpretim te kesaj dispozite, me shkaktim te demit "ne personin ose ne pasurine" e te demtuarit kuptohet jo vetem lidhja ndermjet tij dhe demit, por edhe dallimi ndermjet cenimeve te natyres pasurore dhe atyre jopasurore ne te drejta dhe interesa te ligjshme te te demtuarit.

Neni 639 i K. Civil percakton se: "Vendimi qe verteton veprime te konkurences se pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe percakton masat e nevojshme me qellim zhdukjen e pasojave. N.q.se keto veprime jane kryer me faj personi qe i ka kryer ato detyrohet te shperblej demin".

Demi pasuror sjell si pasoje cenimin e pasurise se te demtuarit ne kuptimin e ngushte ekonomik, pra humbjen e pasurise (deminutio patrimonii) ne menyre te paligjshme. Prandaj

edhe demshperblimi i demit pasuror ka per qellim te riktheje pasurine e te demtuarit ne gjendjen e meparshme, duke "mbushur" diferencen e krijuar ndermjet gjendjes ekonomike aktuale te tij me ate ne te cilin do te ndodhej nese nuk vertetohej fakti i paligjshem (quanti ea res erit, tantam pecuniam condemnato).

Lidhur me demin pasuror, Nenet 486 dhe 640 te K. Civil dallojne humbjen e pesuar nga pakesimi i pasurise, qe njihet si demi aktual apo demi emergjent (damnum emergens) dhe fitimin e munguar (lucrum cessans). Ne parim, dallimi ndermjet demit emergjent (quantum mihi abest) dhe fitimit te munguar (quantum lucrari potui), qendron ne aktualitetin ose jo te interesit pasuror te cenuar. Ne rastin e pare objekt i demit eshte pakesimi, humbja e nje interesi pasuror aktual, pra e nje pasurie qe i perket (in re ipsa) te demtuarit ne castin e shkaktimit te demit. Ne rastin e fitimit te munguar kemi te bejme me pamundesine e perfitimit te nje interesi pasuror te ardhshem, pra te nje pasurie qe ende nuk i perket te demtuarit ne castin e shkaktimit te demit.

Nga analiza e neneve 638 dhe 639 te Kodit Civil si edhe te dispozitave te tjera ne lidhje me demin jashtekontraktor, arrihet ne konkluzionin e qarte se ne rast te demtimit te personalitetit te nje personi fizik apo juridik nga nje akt apo veprim i padrejte dhe shkakesor i shkelësit, mund te kerkohet dhe akordohet te shperblehet si demi material ashtu dhe ai moral. Per njohjen dhe dhënien e shperblimit monetar per demin moral te pesuar mjafton çdo lloj shkak, i qëllimshëm apo nga pakujdesia, mjafton te jetë kryer me faj. Në këtë rast, gjykata çmon se nuk u provua vlera e demit të pretenduar nga paditësi dhe për rrjedhojë ky pretendim duhet të rrëzohet.

Nga ana tjeter referuar Nenit 106 te K. Pr. Civile gjykata çmon se shpenzimet gjyqësore, të llogaritura ne fund të vendimit janë ne ngarkim te pales se paditur. Për sa më sipër u analizua gjykata çmon se kërkesë-padia është e pjeserisht e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

VENDOSI

Pranimin e kërkesë-padisë.

Detyrimin e të paditurve shoqëria *** dhe shoqëria *** të ndalojë menjëherë dhe përgjithmonë prodhimin, shpërndarjen dhe tregëtimin e produkteve bombul gazi në logon « *** » të ambalazhuara në mënyrë të njëjtë të ngjashme me markën e regjistruar « *** » me ambalazhimin e sfondet përkatëse dhe mos përsëritjen e tyre në të ardhmen për shkak se ky përdorim përbën shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale të drejtave të përfituara nga paditësi si markë e mirënjohur dhe mospërsëritjen në të ardhmen.

Urdhërimin e të paditurit të tërheq nga tregu të gjithë sasinë e bombulave të gazit në logon « *** » me përshkrimet e sipërcituara.

Publikimin e këtij vendimi në dy media te shkruara, në faqe te parë për një periudhë prej *** ditësh rresht me shpenzimet e të paditurit.

Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.

U shpall në Tiranë sot më datë 15.07.2019.

Sekretare

Anjeza Nergjoni

Gjyqtare

Eneida Civici

Shpenzime gjyqësore

Taksë gjyqësore
fatura dt.12.11.2018 në vlerën 25,320.00 lekë
Fletëthirrje 600 lekë
Sekretare gjyqësore
Anjeza Nergjoni